


LegalNews

September 2024
Shtator 2024

SPECIAL



Deloitte.

PËRMBLEDHJE E AKTEVE LIGJORE PËR ENERGJI & MJEDIS

Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e mjedisit ka pësuar ndryshime të rëndësishme përmes një sërë aktesh ligjore që forcojnë masat ndëshkuese për shkelësit e rregullave mjedisore.

Disa prej ndryshimeve më të rëndësishme prekin ligjet si vijon:

- Ligj nr. 66/2024 Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar;
- Ligji nr. 67/2024 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2024 Për disa ndryshime në ligjin nr. 162/2014, "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", i ndryshuar;
- Ligji nr. 69/2024 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar;
- Ligji nr. 70/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar".

Ndryshimet ligjore në këto akte konsistojnë në vendosjen e masave administrative për shkelësit, në varësi të natyrës së shkeljes.

Ndryshimet e miratuara parashikojnë gjithashtu ndëshkime për operatorët që nuk përmbushin detyrimet

SUMMARY OF LEGAL ACTS ON ENERGY & ENVIRONMENT

Albanian legislation concerning environmental protection underwent significant changes through a series of legal acts that strengthen punitive measures against violators of environmental regulations.

Some of the changes refer to five laws in the environmental field, specifically:

- Law No. 66/2024 On Amendments to Law No. 10 431, dated 9.6.2011, "On Environmental Protection," as amended;
- Law No. 67/2024 On Amendments and Additions to Law No. 10 440, dated 7.7.2011, "On Environmental Impact Assessment" as amended;
- Law No. 68/2024 On Amendments to Law No. 162/2014, "On the Protection of Air Quality in the Environment," as amended;
- Law No. 69/2024 On Amendments and Additions to Law No. 9587, dated 20.7.2006, "On the Protection of Biodiversity," as amended;
- Law No. 70/2024 On Additions and Amendments to Law No. 10 463, dated 22.9.2011, "On Integrated Waste Management," as amended.

The legal amendments in these acts consist of the imposition of administrative measures for violators, depending on the nature of the violation.

The amendments also provide penalties for operators who fail to fulfil their obligations for

për rikuperimin e mjedisit pas përfundimit të aktiviteteve të tyre, duke vendosur afate të qarta për pagesën e gjobave dhe ekzekutimin e tyre nga zyrat e përmbartimit.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i shtuar është përforcimi i strukturave inspektuese përgjegjëse për monitorimin dhe ndëshkimin e shkelësve të rregullave mjedisore.

- **Ligj Nr. 52/2024** "Për Etiketimin e Produkteve me ndikim në Energji".

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë që produktet që ndikojnë në konsumin e energjisë të jenë të pajisura me etiketat përkatëse që tregojnë eficiencën e tyre energjetike.

Ligji kërkon që furnizuesit dhe tregtarët të ofrojnë informacion të qartë dhe të saktë mbi performancën energjetike të produkteve, në mënyrë që konsumatorët të mund të zgjedhin produkte që ndihmojnë në reduktimin e konsumit të energjisë.

Gjithashtu përcakton detyrime të qarta për etiketimin e produkteve, ku çdo produkt duhet të shoqërohet me një etiketë që klasifikon eficiencën energjetike nga shkronja "A" (*eficienca më e lartë*) deri te "G" (*eficienca më e ulët*). Kjo i ndihmon konsumatorët të krahasojnë lehtësisht produkte të ndryshme bazuar në kursimin e energjisë. Përveç kësaj, informacioni plotësues mbi konsumin e burimeve si uji dhe kimikatat duhet të përfshihet për disa produkte specifike.

Ligji gjithashtu bën rishkallëzimin e disa etiketave, për të reflektuar kërkesat më të ashpra mbi eficiencën energjetike. Kjo nënkupton që

environmental restoration after the end of their activities, setting clear deadlines for the payment of fines, as well as enforcement by enforcement offices.

Another important aspect is the strengthening of the inspection structures responsible for monitoring and penalizing violators of environmental regulations.

- **Law No. 52/2024** "On the Labeling of Energy-Impacting Products".

This law aims to ensure that products affecting energy consumption are equipped with appropriate labels indicating their energy efficiency.

The law requires suppliers and traders to provide clear and accurate information regarding the energy performance of products, enabling consumers to choose products that help reduce energy consumption.

It also sets clear obligations for labelling, mandating that each product be accompanied by a label classifying its energy efficiency from grade "A" (*highest efficiency*) to "G" (*lowest efficiency*). This assists consumers in easily comparing different products based on energy savings. Additionally, supplementary information on resource consumption, such as water and chemicals, must be included for certain specific products.

The law also reclassifies certain labels to reflect stricter requirements on energy efficiency. This means that products previously classified

produktet që më parë klasifikoheshin në klasa të larta për eficiencën e energjisë mund të kalojnë në klasa më të ulëta, duke bërë që konsumatorët të zgjedhin produkte edhe më eficiente.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 68/2012, "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji" shfuqizohet.

- **Vendim Nr. 337, datë 05.06.2024** Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar.

Një nga shtesat më të rëndësishme të këtij vendimi është përfshirja e parashikimit që Furnizuesi i Tregut të Lirë, për nevoja të furnizimit të klientëve të saj në treg të lirë, ka të drejtë, në mënyrë proporcionale, ta sigurojë këtë energji në treg të parregulluar dhe/ose të përdorë tepricat/depozitën nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë.

Gjithashtu, parashikohet se sasia e tepërt nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, pas mbulimit të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose furnizimit të klientëve në tregun e lirë, depozitohet në shoqërinë publike të prodhimit për t'u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë.

in higher energy efficiency classes may be moved to lower classes, encouraging consumers to select even more efficient products.

With the entry into force of this law, Law No. 68/2012, "On Information on Energy Consumption and Other Resources of Energy-Impacting Products," is repealed.

- **Decision No. 337, dated 05.06.2024** On Amendments and Additions to Decision No. 456, dated June 29, 2022, of the Council of Ministers, "On Approving the Conditions for Imposing Public Service Obligations to be Applied to Licensees in the Electricity Sector Engaged in the Activities of Production, Transmission, Distribution, and Supply of Electricity", as amended.

One of the most important additions of this decision is the inclusion of the provision that the Free Market Supplier (FTL), for the needs of supplying its customers in the free market, has the right, proportionally, to provide this energy in the unregulated market and/or use the surplus/deposit from the production of renewable energy sources.

In addition, it is foreseen that the surplus amount from the production of renewable energy sources, after covering the losses of the Distribution System Operator and/or supplying customers in the free market, is deposited in the public production company to be used for needs of universal customer supply.

- **Vendim nr. 387, datë 12.06.2024** "Për kriteret për përdorimin e tokës bujqësore, për kryerjen e aktivitetit agrifotovoltaik dhe eolik në tokat bujqësore, procedurat për monitorimin e ushtrimit të aktivitetit, përfshirë masat për shkelje të kushteve të ushtrimit të aktivitetit dhe përcaktimin e tarifës".

Ky vendim përcakton kriteret për përdorimin e tokave bujqësore për zhvillimin e projekteve agrifotovoltaike dhe eolike, duke synuar një balancë të qëndrueshme midis prodhimit bujqësor dhe energjisë nga burimet e rinovueshme.

Vendimi lejon instalimin e paneleve fotovoltaike në tokat bujqësore me bonitet 7 dhe 8, duke përcaktuar kriteret strikte që garantojnë vijimin e aktiviteteve bujqësore, si dhe ruajtjen e integritetit të tokës.

Projektet agrifotovoltaike duhet të sigurojnë që të paktën 60% e sipërfaqes së tokës të mbetet në përdorim për bujqësi, ndërsa prodhimi bujqësor nuk duhet të bjerë nën 70% të rendimentit të mëparshëm. Për energjinë eolike, kriteret e përdorimit të tokave me bonitet deri në 8 përcaktojnë distanca minimale dhe kërkojnë që 70% e tokës të ruhet për qëllime bujqësore.

Gjithashtu, vendimi parashikon një tarifë prej 1% të vlerës së energjisë së prodhuar, e cila do të përdoret për mbështetjen e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

- **Decision No. 387, dated 12.06.2024** "On the Criteria for the Use of Agricultural Land for Conducting Agrivoltaic and Wind Activities on Agricultural Lands, Monitoring Procedures for the Exercise of Activities, Including Measures for Violations of Activity Conditions and the Establishment of Fees".

This decision establishes the criteria for the use of agricultural land for the development of agrivoltaic and wind projects, aiming for a sustainable balance between agricultural production and energy from renewable sources.

The decision permits the installation of photovoltaic panels on agricultural lands classified with quality ratings of 7 and 8, while setting strict criteria to ensure the continuation of agricultural activities and the preservation of land integrity.

Agrivoltaic projects must ensure that at least 60% of the land area remains in agricultural use, and agricultural production must not fall below 70% of previous yields. For wind energy, the land use criteria for quality ratings up to 8 stipulate minimum distances and require that 70% of the land be preserved for agricultural purposes.

Additionally, the decision establishes a fee of 1% of the value of the produced energy, which will be used to support the agricultural sector and rural development.

- **Udhëzim nr. 4, datë 24.06.2024** "Për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike"

Ky udhëzim përcakton rregullat për llogaritjen dhe faturimin e energjisë termike në ndërtesat me shumë njësi, me qëllim sigurimin e një metodologjie të drejtë dhe transparente.

Aplikimi i kësaj metodologjie është i detyrueshëm për shoqëritë e licencuara që furnizojnë energji termike në ndërtesat kolektive me ngrohje/ftohje qendrore.

Fatura e energjisë termike përbëhet nga një komponent fiks, i cili merr parasysh kapacitetin dhe konsumimin e përbashkët të ndërtesës, dhe një komponent variabël, i cili llogaritet në bazë të konsumit individual të matur.

- Vendim nr. 520, datë 1.8.2024 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 641, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte", të ndryshuar, **(Vendimi nr. 520)**,
- Vendim nr. 522, datë 1.8.2024, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", të ndryshuar **(Vendimi nr. 522)** dhe
- Vendimi nr. 526, datë 1.8.2024, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të

- **Instruction No. 4, dated 24.06.2024** "On the Rules of Determining Thermal Energy Consumption"

This instruction establishes the rules for calculating and billing thermal energy in multi-unit buildings, with the objective of ensuring a fair and transparent methodology.

The application of this methodology is mandatory for licensed companies supplying thermal energy to collective buildings with central heating/cooling systems.

The thermal energy bill consists of a fixed component, which considers the building's capacity and shared consumption, and a variable component, calculated based on the individually measured consumption.

- Decision No. 520, 01.08.2024, On Amendments and Additions to Decision No. 641, dated 01.10.2014, of the Council of Ministers, "On Approving the Rules for the Export and Transit of Non-Hazardous and Inert Waste," as Amended", **(Decision no. 520)**,
- Decision no. 522, dated 01.08.2024, On amendments and additions to Decision no. 371, dated 11.06.2014, of the Council of Ministers, "On the approval of the rules for the delivery of Hazardous waste and the delivery document," as amended **(Decision no. 522)**, and
- Decision no. 526, dated 01.08.2024, On amendments and additions to Decision no. 229, dated 23.04.2014, of the Council of Ministers, "On the approval of the rules for the transfer of

rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, të ndryshuar (Vendimi nr. 526).

Më 01.08.2024, Këshilli i Ministrave ka miratuar tre vendime që synojnë modernizimin e procedurave për menaxhimin e mbetjeve, si dhe për transferimin e tyre, duke fokusuar proceset në dixhitalizimin përmes platformës qeveritare "e-Albania".

Këto vendime përfshijnë rregullat për eksportin, transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme, si dhe dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme.

- **Vendimi nr. 520** sjell ndryshime në rregullat për eksportin dhe transitin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe inerte, duke kërkuar që dokumentet dhe raportimet të kryhen në mënyrë elektronike përmes "e-Albania". Gjithashtu, vendimi parashikon krijimin e një Regjistri Kombëtar për Eksportin e Mbetjeve.
- **Vendimi nr. 522** përfshin parashikime të reja në procesin e dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme. Dokumentet e dorëzimit do të kenë një kod unik, i cili do të raportojë në mënyrë elektronike të dhënat e mbetjeve të rrezikshme të dorëzuara përmes Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
- **Vendimi nr. 526** fokusohet në transferimin dhe dokumentacionin shoqërues të mbetjeve jo të rrezikshme si dhe në raportimin përmes portalit elektronik.

Non-hazardous waste and the information to be included in the transfer document,” as amended (Decision no. 526).

On 01.08.2024, the Council of Ministers approved three decisions aimed at modernizing procedures for waste management and transfer, focusing on digitalization processes through the government platform "e-Albania."

These decisions include rules for the export, transfer of non-hazardous waste, and the delivery of hazardous waste.

- **Decision no. 520** introduces changes to the rules for the export and transit of non-hazardous and inert waste, requiring that documents and reports be submitted electronically via "e-Albania." Additionally, this decision provides about the creation of the National Waste Export Register.
- **Decision no. 522** includes new provisions the delivery of hazardous waste. The delivery documents will have a unique code that will electronically report data on the hazardous waste delivered through the National Environmental Agency.
- **Decision no. 526** focuses on the transfer and accompanying documentation of non-hazardous waste and reporting through the electronic portal.

PËRMBLEDHJE E AKTEVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

- **Vendim njësues i Gjykatës së Lartë "Dëmshpërblimi paraprak nuk shuan detyrimin e punëdhënësit për respektimin e afatit të njoftimit"**

Në [vendimin njësues nr.00-2023-5686\(724\), datë 12.12.2023](#), Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se afati i njoftimit në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës me kohëzgjatje të pacaktuar nga punëdhënësi, nuk konsiderohet i respektuar në kuptim të neneve 141 dhe 143 të Kodit të Punës, kur punëdhënësi i paguan punëmarrësit paraprakisht, në formë dëmshpërblimi, shumën korresponduese të pagave të këtij afati. Ky dëmshpërblim nuk zëvendëson dhe as shuan detyrimin ligjor të punëdhënësit për të vijuar marrëdhënien juridike të punës me punëmarrësin deri në fund të afatit të njoftimit, pavarësisht të drejtës së tij për të mos e zënë në punë punëmarrësin gjatë kësaj periudhe, sipas nenit 129 të Kodit të Punës.

- **Ligji nr. 91/2024, Për disa ndryshime në ligjin nr. 7961, dt. 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.**

Ky ligj është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 143, më datë 09.08.2024 dhe parashikon ndryshime në rregullat për pushimet vjetore të paguara të punëmarrësit. Punëmarrësi ka të drejtë që gjatë vitit të punës të marrë jo më pak se 22 ditë pune leje vjetore të paguara. Gjithashtu, është hequr detyrimi i marrjes së lejes jo më pak se 1

SUMMARY OF LEGAL ACTS ON EMPLOYMENT

- **The unifying Supreme Court Decision "Compensation paid in advance does not discharge the employer's obligation to comply with the notice period" - unified decision**

In the unifying decision [No. 00-2023-5686\(724\), dated December 12, 2023](#), the Civil College of the Supreme Court resolved that the notice period provided in the case of the termination of the employment contract with indefinite duration, shall not be considered observed in light of article 141 and 143 of the Labor Code, when the employer pays a one-off compensation in lieu of all the corresponding salaries which the employee is entitled to receive during the notice period. This compensation does not substitute and does not discharge the employer's legal obligation to continue the employment relationship with the employee until the elapse of the notice period, regardless of the employer's right to not engage the employee with any work provided in article 129 of the Labor Code.

- **Law no. 91/2024, On some changes to law no. 7961, dated 12.7.1995 "Labor Code of the Republic of Albania", as amended**

This act was published in Official Gazette No. 143, dated August 9, 2024, and introduced significant changes to the rules on employee's paid leave. From now on, the minimum annual paid leave has been increased to 22 working days. Additionally, the amendment removes the requirement for at least one uninterrupted calendar week of leave,

(një) javë pa ndërprerje, duke ju mundësuar punëmarrësve fleksibilitet të shtuar.

Ky ndryshim ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare.

- **Vendimi nr. 514, date 01.08.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 538, date 26.05.2009, të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar**

Ky vendim paraqet ndryshimet që pëson Vendimi nr. 538, datë 26.05.2009, lidhur me licencat dhe lejet që jepen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) në Republikën e Shqipërisë.

Ndryshimet lidhen me kushtet dhe procedurat për licencimin e aktiviteteve që lidhen me ndërmjetësimin në tregun e punës dhe shërbimet e formimit profesional. Vendimi ndryshon kriteret specifike dhe dokumentacionin e kërkuar për kualifikimet dhe përvojën e personelit, mjaftueshmërinë e kapitalit, përshtatshmërinë e objekteve dhe pajisjeve, si dhe strukturën organizative të ofruesve të shërbimeve. Gjithashtu, afati i ri për vendimmarrjen e autoritetit licencues, Ministria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, është ndryshuar në 15 ditë.

Subjektet që disponojnë licencë për formim profesional dhe/ose ndërmjetësim në tregun e

granting employees more flexibility regarding their vacation days.

The amendment came into force 15 days after its publication with the Official Gazette.

- **Decision no. 514, dated 01.08.2024 "On some changes and additions to decision no. 538, dated 26.5.2009, of the Council of Ministers, "On licenses and permits that processed by or through the national center of licensing (QKL) and some other sub-legal regulations of common", as amended**

This Decision amends Decision No. 538, dated May 26, 2009 on licenses and permits issued by or through the National Licensing Centre (QKL) in the Republic of Albania.

The amendments are related to the criteria and procedures for the licensing of activities of labor market intermediation and vocational training services. This Decision changes the specific criteria and required documentation for the qualifications and experience of personnel, capital adequacy, the suitability of facilities and equipment, and the organizational structure of service providers. Furthermore, the new deadline for the decision-making of the licensing authority, the ministry responsible for employment and vocational training, is changed to 15 days.

The subjects who possess a licence for vocational training and/or intermediation in the labor market have to take the necessary measures

punës duhet të marrin masat për përshtatjen e licencës brenda afatit kohor prej 120 ditësh kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve përndryshe do t'ju revokohet licenca.

Vendimi ka hyrë fuqi pas publikimit me Fletoren Zyrtare nr. 141, datë 8.8.2024.

PËRMBLEDHJE E AKTEVE LIGJORE PËR SEKTORI E NDËRTIMIT

- **Udhëzim nr.1, datë 17.07.2024 "Për miratimin e modelit dhe përcaktimin e rregullave të mbajtjes së regjistrimit të lejes së ndërtimit, si dhe të procedurave të regjistrimit të kontratave të sipërmarrjes/porosisë dhe të premtim shitjes"**

Ky udhëzim përcakton rregulla për mbajtjen e regjistrimit të lejes së ndërtimit (përfshirë modelin e ri), si dhe procedurat për regjistrimin e kontratave të sipërmarrjes, porosisë dhe të premtim shitjes.

Udhëzimi implementon një sistem të ri digjital për regjistrimin e lejeve të ndërtimit dhe kontratave ndërmjet ndërtuesve dhe blerësve, i aksesueshëm përmes portalit E-Albania. Të interesuarit mund të kërkojnë një certifikatë për regjistrimin e lejes së ndërtimit kundrejt pagesës së një tarife. Bashkia e Tiranës dhe Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) duhet të dorëzojnë lejet e ndërtimit, nën juridiksionin e tyre pranë Agjencisë Kombëtare të Kadastrës (ASHK) si në mënyrë digjitale ashtu edhe me postë. ASHK-së i kërkohet të përditësojë seksionin "B1" të kartës së pronës me të dhënat paraprake të regjistrimit brenda 15 ditëve.

for the adaptation of the licence within 120 calendar days since the entry in force of these changes, otherwise their license will be revoked.

This Decision entered into force after its publication with the Official Gazette No. 141, dated August 8, 2024.

SUMMARY OF LEGAL ACTS ON CONSTRUCTION

- **Instruction no.1 date 17.07.2024 "For the approval of the model and the determination of the rules for keeping the building permit register, as well as the registration procedures of the construction/ordering contract and promise to sell contract"**

This instruction establishes rules on the administration of the building permit register, and the procedures for the registration of the construction/ordering contract and promise to sell contract.

This instruction implements a new digital system for registering building permits and contracts between builders and buyers, accessible through the E-Albania portal. Interested parties can request a certificate for building permit registration by paying a fee. The Tirana Municipality and the National Council of Territory (NCT) must submit building permits, under their jurisdiction to the National Agency of Cadastre (NAC) both digitally and via postal. The NAC is required to update Section "B1" of the property card with preliminary registration data within 15 days.

Për të regjistruar kontratat, palët duhet të plotësojnë kushte specifike, duke përfshirë respektimin e Ligjit për Noterinë Publike dhe sigurimin e informacionit të plotë në aktin noterial. Nëse plotësohen këto kushte, ASHK do të regjistrojë aktin në seksionin "D" të kartelës së pronës. Palët duhet të korrigjojnë çdo informacion që mungon brenda 30 ditëve ose rrezikojnë refuzimin e regjistrimit.

Të gjitha lejet ekzistuese manuale të ndërtimit duhet të kalojnë në regjistrin digjital, përveç rasteve kur janë regjistruar tashmë në regjistrin e karabinasë të ndërtesës ose që janë përfunduar. Kontratat e ardhshme do të regjistrohen vetëm pas regjistrimit të lejes së ndërtimit në regjistrin e lejeve.

Udhëzimi hyri në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 22.7.2024 dhe shfuqizoi Udhëzimin nr.1, datë 13.4.2016.

- **Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshme dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar**

Ky Vendim i Këshillit të Ministrave ka parashikuar një sërë ndryshimesh dhe shtesash në Rregulloren për Zhvillimin e Territorit, ndër të tjera në lidhje me ndëreveprimin e autoritetit të zhvillimit dhe institucioneve të tjera të përfshira në procesin e lejeve, kategoritë e punimeve për të cilat nuk duhet leje ndërtimi ose që mund të kryhen me deklaratë paraprake, punimet në zonat rurale si dhe kompetencat e procedurat për pajisjen me leje pranë autoriteteve

To register contracts, parties must meet specific conditions, including compliance with the Law on Public Notaries and all the needed information to be provided in the notarial act. If these conditions are verified, the NAC will register the act in Section "D" of the property card. Parties must correct any missing information within 30 days or risk denial of registration.

All existing manual building permits must transition to the digital register unless already recorded in the building carcass register or fully constructed. Future contracts will be registered only after building permits are registered into the register. Instruction No. 1, dated April 13, 2016, is hereby repealed.

This instruction entered into force after the publication with the Official Gazette no. 123, dated 22.7.2024 and repealed Instruction no.1, dated 13.4.2016.

- **The Decision of the Council of Ministers "On some changes and additions to decision no. 408, dated 13.05.2015, of the Council of Ministers, "On the approval of the territorial development regulation", amended**

This Decision of the Council of Ministers has provided wide-encompassing changes and additions to the Regulation on the Development of Territory, among others in relation to the interaction between the development authority and other institutions involved in the process of permits' issuance, the category of works for which no permit is necessary or the works that can be performed with a prior declarations, works in rural areas, as well as

zhvillimore, përfshirë institucionin e riemërtuar Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit (KKTU) me kompetenca edhe në përdorimin e burimeve ujore.

Kjo VKM ka shtuar përkufizime të reja të tilla si përkufizimet për banesat njëfamiljare dhe zonat rurale, projektet TIP.

Më tej, akti ka rikategorizuar disa punime, duke përjashtuar ato që nuk kanë nevojë për leje ndërtimi, si strukturat e lehta, shtrimi i oborrit dhe punimet për infrastrukturën e telekomunikacionit. Punimet në zonat rurale mund të vazhdojnë me një njoftim të thjeshtë tek autoritetet vendore për modifikime të brendshme dhe të vogla të jashtme.

Vendimi gjithashtu ka sjellë ndryshime tek kategoria e punimeve që kanë nevojë për deklaram paraprak, duke kategorizuar si të tilla punimet për strukturat e hapura sportive dhe pishinat. Për projektet, që përfshihen në këtë kategori në zonat e brezit detar, kërkohet një akt konfirmimi nga Sekretariati i KKTU.

Kërkesat dhe kriteret për pajisjen leje zhvillimi dhe leje ndërtimi kanë pësuar ndryshime. Lejet e ndërtimit në rastin e ndërtesave njëfamiljare për përdorim vetjak, rastet kur nuk ka nevojë për leje zhvillimi ose leje ndërtimi. Dokumentacioni që duhet për tu pajisur me leje ndërtimi ose leje zhvillimi ka pësuar ndryshime. Për lëshimin e lejes së ndërtimit pjesë e projektit duhen projektet e instalimeve për rrjetet e telekomunikacionit /komunikimit elektronik, projekti i gjelbërimit dhe projekti i mobilimit urban dhe hapësirave rekreative e argëtuese.

